



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:028769
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05526160

CA.nr.3302/24

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka-kryetare e kolegjit, Kujtim Pasuli dhe Naime Ahmeti, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit- propozuesit të sigurimit J.K. nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E.Sh.M., avokate nga Prizreni, kundër të paditurës E.K. nga Prizreni, lagjja ..., rruga "...", nr...., për kthimin e gjësendeve personale dhe kompensimin e dëmit, me propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, duke vendosur sipas ankesës së propozuesit të sigurimit, e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.451/24 i datës 07.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 29.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit- propozuesit të sigurimit J.K. nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.451/24 i datës 07.02.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar C.nr.451/24 i datës 07.02.2024, e ka hedhë poshtë si të palejuar kundërshtimin e paditësit-propozuesit J.K. nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, i paraqitur ndaj aktvendimit me shenjë C.nr.451/2024, të datës 29.01.2024.

Kundër këtij aktvendimi propozuesi i sigurimit nëpërmes përfaqësueses së autorizuar në afat ligjor ka ushtruar ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit ta anuloj aktvendimin e atakuar dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:
Ankesa e propozuesit të sigurimit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi - propozuesi i masës së sigurimit me datë 21.01.2024 në gjykatën e shkallës së parë ka ushtruar padi kundër të paditurës për kthimin e gjësendeve personale dhe kompensimin e dëmit, me propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, me kërkesë dhe arsye sikurse në padinë dhe në propozimin e ushtruar.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin C.nr.451/2024, të datës 29.01.2024, e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e propozuesit- paditësit J.K. nga fshati ..., komuna e Prizrenit, për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë. Kundër këtij aktvendimi propozuesi i masës së sigurimit me dt. 06.02.2024, kishte paraqitur kundërshtim.

Gjykata e shkallës së parë pas analizimit të shkresave të lëndës dhe kundërshtimit të paraqitur me aktvendimin e ankimuar C.nr.451/24 i datës 07.02.2024, e ka hedhë poshtë si të palejuar kundërshtimin e paditësit-propozuesit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se në kuptim të dispozitës së nenit 310 paragrafi 5 i LPK-së, është vendosur që të hedhet ankesa si e palejuar sepse ndaj aktvendimit mbi masën e përkohshme nuk lejohet ankesa. Ka shtuar se pala paditëse përmes këshillës juridike të dhënë në aktvendimin e datës 29.01.2024, ka qenë e udhëzuar se: *“kundër këtij aktvendimi, bazuar në nenin 310, par.5 të LPK-së, nuk është e lejuar ankesa”*, ndërsa në anën tjetër kundërshtimi mbi vendimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, bazuar në nenin 306 par.2 të LPK-së, mund të paraqitet vetëm ndaj aktvendimit me të cilën caktohet masa e përkohshme e sigurisë dhe atë nga kundërshtari i sigurimit. Nga këto arsye kundërshtimin e ushtruar nga propozuesi i sigurimit e ka hedhë si të palejuar.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),(j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuuese me ankesë.

Është i drejtë vlerësimi juridik i gjykatës së shkallës së parë me rastin e vendosjes për hedhjen e kundërshtimit si të palejueshëm sepse me dispozitën e nenit 310 paragrafi 5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore përcaktohet se: “*kundër aktvendimit mbi masën e përkohshme nuk lejohet ankimi*”, ndërsa me dispozitën e nenit 306 par.2 të LPK-së parashihet se kundërshtimi mund të paraqitet vetëm ndaj aktvendimit me të cilën caktohet masa e përkohshme e sigurisë dhe atë nga kundërshtari i sigurimit.

Nga interpretimi i dispozitave të sipërcituara ligjore kolegji i Gjykatës së Apelit, vlerëson se përfundimi i gjykatës së shkallës së parë për mënyrën e vendosjes është i drejtë dhe i ligjshëm, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të cekurat më lart, e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 pika (b) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.3302/24, me datë 29.03.2024

Kryetarja e kolegjit
Halide Reka, d.v.